

INSTITUTI I STATISTIKAVE
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1484 Prot.

Datë 25/08/2025

ZYRA E UNICEF-it
NË SHQIPËRI

Ref. ALB/25/071

Datë 08/08/2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE TË SHQIPËRISË

dhe

ZYRËS SË UNICEF-it NË SHQIPËRI

për zbatimin e projektit

"Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2025-2026"

Hyrje

Duke qënë se, Zyra e Fondit për Fëmijë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (më tej i referohemi si UNICEF) dhe Instituti i Statistikave të Shqipërisë (më tej i referohemi si INSTAT) ndajnë një objektiv të përbashkët në kuadër të mandateve të tyre; dhe përkatësisht, monitorimin e mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe grave;

Duke qënë se, Qeveria e Shqipërisë dhe UNICEF-i kanë përcaktuar, si një nismë kryesore në Programin e Bashkëpunimit të UNICEF 2022-2026, të gjenerojnë të dhëna mbi treguesit e Objektivave e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe angazhimet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar të dhëna që në mënyrë specifike monitorojnë situatën e fëmijëve dhe grave në Shqipëri;

Duke qënë se, Qeveria e Shqipërisë është dakordësuar përmes Planit të Përbashkët të Punës 2025 – 2026 të Qëllimit Strategjik 3 – Qeverisja, Sundimi i Ligjit dhe të Drejtat e Njeriut, si një pjesë integrale e Kornizës së Kombeve të Bashkuara për Bashkëpunim të Qëndrueshëm për Shqipërinë 2022 - 2026;

Në funksion të gjithë kësaj dhe duke u bazuar në besimin e ndërsjellë dhe në frymën e bashkëpunimit, INSTAT dhe UNICEF bien dakord si më poshtë:

Neni I. Përkufizimet

Për qëllimet e Marrëveshjes në fjalë do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. Me "Palët" nënkuptohet INSTAT dhe UNICEF.
2. Me "UNICEF" nënkuptohet Zyra e Fondit për Fëmijë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, agjenci degë e Kombeve të Bashkuara e themeluar mbi bazën e Rezolutës 57 (i) miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 11 dhjetor 1946.
3. Me "Marrëveshje" ose "Marrëveshja në fjalë" nënkuptohet Marrëveshja e Bashkëpunimit aktual dhe shtojca e tij mbi Bashkëpunimin Teknik për zbatimin e projektit të titulluar "Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2025-2026".
4. Me "Planin dhe Buxhetin e Anketës" nënkuptohet plani zbatues i Marrëveshjes, të cilin Palët pajtohen ta zbatojnë së bashku.
5. Me "Projekt" nënkuptohen të gjitha dokumentet, proceset dhe pajisjet përbërëse të projektit "Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2025-2026".
6. "Përfaqësuesi i UNICEF-it" nënkupton Shefin e Zyrës së UNICEF-it në Shqipëri.
7. Me "Shpenzime" nënkuptohen të gjitha pagesat dhe të gjitha zotimet që lidhen me zbatimin e Projektit.
8. Me "Forcë madhore" nënkuptohen fatkeqësitë natyrore, lufta (e deklaruar ose e padeklaruar), pushtimi, revolucioni, kryengritja ose çfarëdo ngjarje tjetër e kësaj natyre.
9. Me "Ekipin e MICS-it nga UNICEF-i" nënkuptohet stafi dhe konsulentët e UNICEF-it në Zyrat e Vendit, ato Rajonale dhe në selinë e Firences/Nju Jorkut që angazhohen në koordinimin, menaxhimin dhe ofrimin e asistencës teknike për projektin, si pjesë e programit global të MICS-it.

Neni II. Objektivi dhe fushëveprimi i Marrëveshjes

1. Marrëveshja përcakton termat, kushtet dhe procedurat për bashkëpunim midis Palëve në lidhje me përmbushjen e objektivave të Projektit.
2. Palët pajtohen të bashkëpunojnë dhe të mbajnë një marrëdhënie të ngushtë pune për të përmbushur objektivat e Projektit dhe për të zhvilluar detajet teknike dhe operative të zbatimit të projektit në Planin dhe Buxhetin e Anketës, në përputhje me rekomandimet e përgjithshme të programit global të MICS-it, duke përfshirë Bashkëpunimin Teknik të përshkruar në Shtojcë.
3. INSTAT dhe Ekipi i MICS-it nga UNICEF do të kenë qasje në të gjitha dokumentet e projektit, duke përfshirë planet e kampionimit, programet e përpunimit të të dhënave, skedarët e të dhënave mikro të anonimizuara, tabelat për ecurinë dhe cilësinë e mbledhjes

së të dhënave në terren të anonimizuara, programet e tabulimit, dhe të gjitha dokumentet e tjera teknike në çdo kohë gjatë zbatimit të anketës për qëllimin e shqyrtimit teknik dhe garantimit të cilësisë.

4. INSTAT dhe Ekipi i MICS-it nga UNICEF-i do të kenë qasje në pyetësorët dhe pre-testet e aplikacionit për mbledhjen e të dhënave, punën në terren dhe përpunimin e të dhënave dhe trajnimet përkatëse me qëllim të garantimit të cilësisë, si dhe për aktivitetet e monitorimit.
5. INSTAT dhe Ekipi i MICS-it nga UNICEF-i në asnjë rrethanë nuk do t'i ndajnë plotësisht ose pjesërisht të dhënat mikro me ndonjë person apo subjekt jashtë anëtarëve të vet përpara shpërndarjes publike të rezultateve dhe anonimizimit të të dhënave mikro. Në situata të jashtëzakonshme, Palët mund të dakordësohen për ndarjen e të dhënave dhe marrësi bie dakord për ruajtjen e konfidencialitetit të tyre. Çdo rezultat i analizës nuk duhet ti mundësohet asnjë personi apo entiteti jashtë INSTAT-it dhe Ekipit të MICS-it nga UNICEF-i, përveç rasteve kur palët bien dakord. Kjo analizë përfshin, por nuk kufizon, tabulimin e papublikuar të Draft Raportit të gjetjeve të studimit të papublikuara.
6. Palët pajtohen që do të bëhet çdo përpjekje për të publikuar Raportin e Gjetjeve të Anketës, duke përfshirë të gjitha detajet metodologjike, tabelat dhe shtojcat, brenda 6 muajve pas përfundimit të punës në terren. Nëse vërehet se procesi mund të tejkalojë këtë afat, Ekipi i MICS-it nga UNICEF-i, në bashkëpunim, do të përshkallëzojë mbështetjen teknike dhe në konsultim me INSTAT-in, do të zhvillojë Raportin e Gjetjeve të Anketës dhe do t'ia dorëzojë INSTAT-it.
7. Në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare¹, skedarët e të dhënave mikro të anketës do të anonimizohen nga INSTAT-i në atë mënyrë që të mos zbulohet asnjë informacion që do të lejonte identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të personit(ave) të veçantë, njërive ekonomike familjare të intervistuar ose vendndodhjen e zonës gjeografike të kampionimit. Nuk do të shpërndahej asnjë informacion personal në lidhje me cilindo individ apo njësi ekonomike familjare.
8. Detajet mbi shkëmbimin e të dhënave të anonimizuara gjeospaciale do të shqyrtohen dhe dakordësohen mes ekipit të INSTAT dhe MICS të UNICEF veçmas.
9. MICS do të përfshihet në kategorinë e skedarëve për përdorim publik (Public Use Files) sipas Kapitullit II, neni 5 i rregullores së INSTAT për aksesin në mikro të dhëna², dhe palët do të kenë të drejta të barabarta ndaj skedarëve të mikro të dhënave të anonimizuara të

¹ Ligji 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" - https://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf

Ligji 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale" - <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/12/19/124/921d3810-ab2a-4e45-bdca-bef3a84b2721>

² INSTAT (2021). Rregullorja e Aksesit në të Dhënat Mikro

https://www.instat.gov.al/media/9946/rregullore_e_aksesit_n%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnat_mikro____.pdf

anketës. Jo më vonë se një muaj pas publikimit të gjetjeve të Anketës, skedarët e mikro të dhënave të anonimizuara, do të bëhen të disponueshëm për publikun nga INSTAT në www.instat.gov.al dhe do të ndahen me UNICEF-in për t'u shpërndarë (përfshihet gjeokodimi) përmes faqes globale të MICS (mics.unicef.org), për analizë statistikore legjitime, me kërkesë të përdoruesve të regjistruar.

10. Publikimi i të dhënave të anonimizuara mikro në faqen globale të MICS (mics.unicef.org) do të kushtëzohet me dakordësimin nga ana e përdoruesit për të dhënë mirënjohje specifike të kontributit të dhënë nga INSTAT në zbatimin e anketës dhe mbledhjen e të dhënave, si dhe sigurimin e një kopje për INSTAT-in dhe UNICEF-in të çdo raporti/analize të prodhuar nga përdorimi i të dhënave. Përdoruesit nuk do të lejohen të shpërndajnë të dhënat mikro dhe/ose t'i mbajnë ato në ndonjë platformë tjetër publike.
11. Para se të bëjnë çfarëdo ndryshimi në grupet e të dhënave mikro që janë duke u shpërndarë, Palët pajtohen të konsultohen me njëra-tjetrën dhe dakordësohen mbi ndryshimet që mund të jenë teknikisht të nevojshme. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar që marrësit e skedarëve të të dhënave mikro deri në atë moment të jenë njoftuar për ndryshimet e bëra.
12. Palët pajtohen të inkurajojnë dhe ndërmarrin aktivitete për shpërndarjen e të dhënave që promovojnë përdorimin e rezultateve të anketës dhe të dhënave mikro të anonimizuara, në formën e analizave sekondare. Për qëllime të tilla, UNICEF-i mund të bëjë rikodimin e të dhënave mikro për të prodhuar një grup uniform të të dhënave me të gjitha anketat e MICS-it dhe t'i përdorë këto të fundit në platformat online për tabulime ndërkombëtare të ruajtura në faqen globale të MICS-it. Një bazë e tillë e të dhënave nuk do të vihen në dispozicion të publikut.

Neni III. Afati i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të gjitha Palët dhe do të mbetet në fuqi deri në 31 Dhjetor 2026. Projekti do të fillojë dhe përfundojë në përputhje me afatin e përcaktuar në Planin dhe Buxhetin e Anketës, i cili mund të përditësohet gjatë rrjedhës së Projektit. Plani dhe Buxheti i Anketës do të nënshkruhet nga të dyja Palët.
2. Nëse gjatë zbatimit të Projektit, cilado Palë përcakton se data e përfundimit e vendosur në Nenin III (1) më sipër, duhet të zgjatet për të përmbushur objektivat e projektit, Pala në fjalë do ta informojë tjetrën, pa vonesë, në mënyrë që të fillohen konsultimet për të arritur një marrëveshje me një datë të re të përfundimit. Pas arritjes së një marrëveshjeje për një datë të re përfundimi, Palët nënshkruajnë një amendament për këtë qëllim, në përputhje me Nenin XII.

Neni IV. Përgjegjësitë e përgjithshme dhe të veçanta detyruese për Palët

1. Palët pajtohen të përmbushin përgjegjësitë e tyre të veçanta në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. INSTAT bie dakord që në dispozicion të Projektit të vendosë personelin teknik dhe administrativ që do të kryejë dhe menaxhojë MICS-in, në përputhje me kërkesat dhe kualifikimet profesionale të theksuara në Projekt, veçanërisht në Planin dhe Buxhetin e Anketës.
3. Palët do të marrin përgjegjësinë për monitorimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Projektit.
4. INSTAT pranon të vendosë në dispozicion të Projektit, ambiente/infrastrukturë fizike të kërkuara në mënyrë që MICS-i të kryhet plotësisht.
5. Palët pajtohen të financojnë dhe të kërkojnë fonde për të mbuluar kostot operative (transportin, dietat e udhëtimit, materialet, burimet njerëzore, etj.), të nevojshme për të zbatuar Projektin në mënyrë të kënaqshme, sipas dhe deri në kufirin që do të përcaktohet në Planin dhe Buxhetin e Anketës.
6. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjelltë për të siguruar dhe marrë të gjitha licencat dhe lejet e kërkuara nga legjislacioni kombëtar (përfshirë miratimet etike), me kusht që licencat dhe lejet e tilla janë të përshtatshme dhe të nevojshme për të përmbushur objektivat e Projektit.
7. Të dyja palët do të sigurojnë që vlerësimet etike të pasqyrohen dhe të lehtësohen për aq sa është e mundur dhe të sigurohen mekanizmat për të mbrojtur anëtarët e njësive ekonomike familjare pjesëmarrëse në anketë, palët e interesit dhe Palët pjesëmarrëse në zbatimin e Projektit.
8. INSTAT pajtohet që asnjë individ që merr pjesë në ose administron anketën pranë njësive ekonomike familjare nuk duhet të ndiqet penalisht, si pasojë e pyetjeve të paraqitura dhe përgjigjeve të dhëna brenda anketës.
9. Të dyja Palët do të caktojnë personat përgjegjës të cilët do të veprojnë si kanal kryesor i komunikimit midis Palëve për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Projektin.
10. Të dyja Palët do të jenë anëtarë të plotë të Komiteteve Drejtuese dhe Teknike të themeluara për të mbikëqyrur Projektin. Këto komitete nuk mund të marrin vendime që ndryshojnë këtë Marrëveshje në tërësi ose pjesërisht.
11. Asistenca teknike do të sigurohet nga Ekipi i MICS-it nga UNICEF-i gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit. Asistenca teknike në vazhdimësi do t'i ofrohet Projektit përmes vizitave në Shqipëri dhe mbështetjes në distancë nga konsulentët rajonal të UNICEF-it në tri fusha kryesore: Kampionimi, Përpunimi i të Dhënave dhe Implementimi i Anketës së Njësive Ekonomike Familjare, si dhe mbështetja nga Ekipi Global i MICS-it në zyrat rajonale dhe qendrore të UNICEF-it. Palët pajtohen të përcjellin këtë asistencë teknike dhe objektivat e saj, sikur janë përshkruar në Kornizën e Bashkëpunimit Teknik të Programit Global të MICS-it (shtojca).
12. Ekipi i MICS-it nga UNICEF-i po ashtu do të ofrojë asistencë teknike për Projektin

nëpërmjet 2 seminareve të MICS-it në të cilat të dy Palët dakordësohen të marrin pjesë me personelin përkatës të Projektit;

- a. Përpunimi i të dhënave: puna me pjesëmarrësit në programin e futjes së të dhënave (CSPRO), softuerin e tabulimit (SPSS) dhe instrumentat e arkivimit.
- b. Interpretimi i të Dhënave, Analiza e Mëtejshme dhe Shpërndarja: puna me pjesëmarrësit në shqyrtimin e gjetjeve, dhe planet për shpërndarjen e të dhënave e analizave të mëtejshme.

Neni V. Kërkesat e personelit

1. INSTAT -i garanton respektimin e të gjitha ligjeve kombëtare të punës që mund të jenë të zbatueshme dhe do të paguajë dhe sigurojë pagat e të gjithë punonjësve të caktuar në Projekt në kohën e duhur. Kuptohet që UNICEF-i nuk do të pranojë përgjegjësi për asnjë kërkesë që rezulton nga vdekja, lëndimet trupore, paaftësia, dëmtimi i pronës ose rreziqet e tjera të pësura nga punonjësit e INSTAT-it, si pasojë e punësimit ose punës së tyre lidhur me Projektin. Rrjedhimisht, do të jetë përgjegjësi e INSTAT-it të mbulojë dhe sigurojë të gjitha kompensimet e duhura për punonjësit e saj dhe të ofrojë detyrimin e mbulimit me siguracion për të mbrojtur punonjësit e saj në ndonjërin nga rastet e lartpërmendura, së bashku me të gjitha politikat e tjera të sigurimit të dakordësuara nga Palët.
2. UNICEF-i është përgjegjës për punësimin e konsulentëve dhe personelit të përkohshëm të identifikuar të ndihmës teknike, sipas nevojës, për të përmbushur objektivat e Projektit, sipas termave të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara. Termat e referencës do të konsultohen me INSTAT-in. UNICEF-i gjithashtu do të ofrojë ndihmën teknike, sigurimin e cilësisë dhe proceset e shqyrtimit sipas nevojës dhe sikur kërkohet nga pjesëmarrja në Programin Global të MICS-it. Konsulentët dhe personeli i përkohshëm i ndihmës teknike do të gëzojnë privilegjet e ofruara për personelin e Kombeve të Bashkuara. Punësimi i ekspertëve, teknikëve dhe konsulentëve nga UNICEF-i do të jetë pa diskriminim për shkak të racës, fesë, gjinisë, aftësisë së kufizuar, grupit etnik, origjinës kombëtare ose faktorëve të ngjashëm. Të gjitha kontratat e konsulencës duhet të përfshijnë klauzolën për konfidencialitetin në lidhje me të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e përpiluara gjatë Projektit.

Neni VI. Furnizimet, automjetet dhe blerjet

1. Materialet, inputet dhe mallrat e tjera jo-konsumuese të furnizuara apo të financuara nga UNICEF do të transferohen në INSTAT pas përfundimit. Nëse automjetet merren me qera nga UNICEF-i, për qëllime të Projektit, UNICEF-i do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kujdesin e duhur.
2. Të gjitha furnizimet jashtë vendit të financuara me burime të UNICEF-it do të prokurohen nga UNICEF-i. Duke pasur parasysh privilegjet dhe imunitetin që gëzon, organizata në

fjalë është e përjashtuar nga pagesa e taksave të drejtpërdrejta ose tarifave doganore.

3. Si pjesë e Projektit, do të mbahen shënime të plota dhe të sakta për të gjitha inputet, pajisjet dhe mallrat e tjera të blera me fondet e UNICEF-it, dhe inventaret e rregullta fizike të të gjitha pajisjeve, mallrave, materialeve dhe furnizimeve jo-konsumuese. Arkivimi dhe asgjësimi përfundimtar i këtyre shënimeve duhet të ndodhë sipas udhëzimeve institucionale mbizotëruese për periudhat e mbajtjes.

Neni VII. Marrëveshjet financiare dhe operacionale

1. Fondet e caktuara për Projektin nga UNICEF-i do të menaxhohen në përputhje me politikat dhe procedurat operative të UNICEF-it dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Dokumentacioni i nevojshëm për raportimin financiar do të sigurohet me kohë nga INSTAT, në përputhje me Marrëveshjen e Harmonizuar të Transfertave të Parave (HACT) dhe dispozitat e Planit të Përbashkët të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë.
2. INSTAT-i do të sigurojë personelin dhe shërbimet që do të dakordësohen në Planin dhe Buxhetin e Anketës.

Neni VIII. Ndërprerja e parakohshme

1. Secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje tridhjetë ditë pas njoftimit me shkrim për këtë qëllim, nëse Pala tjetër nuk është në gjendje ose nuk ka vullnet, ose në ndonjë mënyrë pengohet të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë e saj sipas Marrëveshjes, duke rrezikuar kështu përmbushjen e objektivave të projektit, dhe pasi është siguruar që palët janë konsultuar, pa sukses, për të eliminuar pengesën.
2. Pas njoftimit të ndërprerjes, sikur parashikohet në paragrafin e mësipërm, Palët duhet menjëherë të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të finalizuar aktivitetet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar menjëherë dhe në mënyrë të organizuar, me qëllim të minimizimit të humbjeve dhe shpenzimeve shtesë. UNICEF-i nuk do të japë asnjë fond shtesë për Projektin.
3. Brenda tridhjetë ditësh nga njoftimi i ndërprerjes, INSTAT-i do t'i kthejë UNICEF-it bilancin e mbetur të fondeve që UNICEF-i do të mund t'i ketë dhënë në përputhje me planin e ekzekutimit të përfshirë në këtë Marrëveshje, me kusht që këto fonde të mos kenë qenë të zotuar në mënyrë të pakthyeshme në kohën kur është dhënë njoftimi për ndërprerje.

Neni IX. Forca madhore

1. Në rast të forcës madhore, sikur përcaktohet në Nenin I (8), secila Palë do ta këshillojë tjetrën menjëherë. Nëse Pala ose Palët nuk janë në gjendje të përmbushin të gjitha ose një pjesë të detyrimeve ose përgjegjësi të pranuar sipas Marrëveshjes së Projektit, detajet e ngjarjes dhe pasojat duhet të komunikohen, nëse është e mundur, me shkrim. Palët do

të konsultohen për masat e duhura që duhet të ndërmerren. Kjo mund të përfshijë pezullimin e Projektit ose ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse Marrëveshja do të ndërpritet për shkaqe që përbëjnë forcë madhore, aplikohen dispozitat e nenit VIII, paragrafët 2 dhe 3.

Neni X. Arbitrazhi

1. Çdo mosmarrëveshje, polemikë ose kërkesë që rrjedh nga kjo Marrëveshje ose në lidhje me të, si edhe shkelja dhe ndërprerja e mëvonshme e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk zgjidhet në mënyrë miqësore përmes negociatave të drejtpërdrejta, duhet të paraqitet, me kërkesë të cilësdo Palë, tek një gjykatë arbitrazhi e përbërë nga tre arbitra. INSTAT-i do të emërojë njërin nga arbitrat; Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të emërojë një tjetër. Këta dy arbitra do të emërojnë arbitrin e tretë. Nëse njëra nga palët dështon të emërojë një arbitër brenda 30 ditëve nga ftesa për ta bërë këtë nga Pala tjetër, ose nëse dy arbitrat dështojnë të arrijnë një marrëveshje për arbitrin e tretë brenda 30 ditëve nga emërimi i tyre, Gjyqtari kryesor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë do të procedojë me emërimet e nevojshme me kërkesë të cilësdo Palë. Arbitrat do të vendosin procedurat për arbitrazh dhe kostot e arbitrazhit do të barten nga Palët në një proporcion që do të përcaktohet nga arbitrat. Vendimi ose dhënia e arbitrazhit do të tregojë motivet mbi të cilat bazohet dhe do të pranohet nga palët si një vendim i detyrueshëm i polemikës, edhe nëse lëshohet në mungesë të njëres prej Palëve.

Neni XI. Privilegjet dhe imuniteti

1. Asgjë që përmban kjo Marrëveshje ose që lidhet me të nuk mund të konsiderohet si një heqje e shprehur ose e nënkuptuar e ndonjë privilegji ose imuniteti të përcaktuar për Kombet e Bashkuara dhe UNICEF-i.
2. Për të gjitha qëllimet e tij, Planit i Veprimit i Programit të Shqipërisë i dakordësuar ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Zyrës së UNICEF-it në Shqipëri për 2022-2026 do të ketë përparësi mbi çdo dispozitë të Marrëveshjes që mund të jetë në konflikt me të.

Neni XII. Ndryshimet

1. Marrëveshja në fjalë ose dokumentet e bashkangjitura të saj mund të modifikohen ose të ndryshohen vetëm përmes një marrëveshjeje me shkrim të nënshkruar nga të dyja Palët.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit e mëposhtëm, të autorizuar për këtë qëllim dhe duke vepruar si përfaqësues të Palëve, vendosin nënshkrimet e tyre në Marrëveshjen në fjalë në datën dhe në vendin e treguar më poshtë:

Nënshkruar në Tiranë më 08-08. 2015

Në emër të

Instituti i Statistikave (INSTAT)

Elsa Dhuli

Drejtori i Përgjithshëm



Zyra e UNICEF-it në Shqipëri

Murat Sahin

Përfaqësues

08 Aug 2015



SHTOJCA
e MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
mbi
BASHKËPUNIMIN TEKNIK
ndërmjet
INSTITUTIT TË STATISTIKAVE TË SHQIPËRISË (INSTAT) dhe ZYRES SE UNICEF-it
në SHQIPËRI
për zbatimin e Projektit
"Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2025-2026"

I. Qeverisja dhe Burimet

1. **Plani dhe Buxheti i Anketës.** Plani dhe Buxheti i Anketës hartohet në nivel vendi dhe ndahet me Zyrën Rajonale (ZR)/Zyrën Qendrore (ZQ) të UNICEF-it për shqyrtim. Mund të ketë disa draftime të Planit dhe Buxhetit të Anketës që zhvillohen përgjatë fazave të planifikimit dhe dakordësohen nga të dyja palët.
2. **Komitetet e Anketës.** Themelohen komitetet Drejtuese dhe Teknike. Komiteti Drejtues është organi kryesor konsultativ përgjegjës për MICS. Roli kryesor i Komitetit Teknik është të këshillojë Komitetin Drejtues për vendimet teknike, proceset dhe përmbajtjen e anketës. Format e përgjithshme të Termave të Referencës për Komitetet Drejtuese dhe Teknike ofrohen nga ZR/ZQ e UNICEF-it.

II. Përgatitjet teknike për mbledhjen e të dhënave

1. **Ndërtimi i Pyetësorëve.** Përshtaten draft pyetësorët të bazuar në pyetësorët standard të MICS-it dhe ndahen me ZR dhe/ose ZQ e UNICEF-it për shqyrtim. Pasi arrihet një marrëveshje ndërmjet palëve për pyetësorët si rezultat i shqyrtimeve të shumëfishta dhe komenteve të pranuara, ndërtohen pyetësorët për para-testim. Gjatë ose drejt përfundimit të procesit të shqyrtimit, pyetësorët përkthehen në shqip dhe bëhet përkthimi invers për të siguruar që pyetësorët standard të MICS-it dhe ato në shqip janë plotësisht në përputhje. Përkthimi i Manualit për hartëzimin dhe listimin e njësive ekonomike familjare (përkthuar në II.4), intervistuesve dhe mbikëqyrësve bëhet përafërsisht në të njëjtën kohë. Përkthimet inverse shqyrtohen gjithashtu nga ZR dhe/ose ZQ e UNICEF-it.
2. **Kampionimi.** Kampioni i anketës ndërtohet në vend. Dokumenti i ndërtimit të kampionit hartohet nga eksperti kombëtar i kampionimit dhe shqyrtohet nga eksperti rajonal i kampionimit, i cili duhet të ketë qasje në të gjithë informacionin në kornizën e kampionit. Pasi të finalizohet dokumenti i ndërtimit të kampionit, prodhohet versioni i parë i fletës

së punës për llogaritjen e peshave të kampionit në përputhje me formatin e MICS-it dhe ndahet me ZR të UNICEF-it për shqyrtim. Bëhet përzgjedhja e fazës së parë të kampionit.

3. **Kodimi gjeografik (gjeokodimi).** Kufinj të gjeografikë të kampionimit janë në dispozicion në INSTAT dhe nuk ka nevojë të mbledhen gjatë listimit. Detajet mbi shkëmbimin e të dhënave gjeografike të anonimizuara mes INSTAT dhe UNICEF do të shqyrtohen dhe dakordësohen veçmas.
4. **Shqyrtimi etik.** Pas marrëveshjes ndërmjet UNICEF-it dhe INSTAT-it për materialet e anketës të cilat përmbledhin protokollin e anketës (p.sh. Draftin e Planit dhe Buxhetit të Anketës me draft pyetësorët, protokollin e mbrojtjes, planin e kampionit), këto ndahen me bordin e duhur të shqyrtimit etik. Materialet do të përshtaten dhe finalizohen, bazuar në gjetjet e bordit shqyrtues, dhe kërkohet miratimi përfundimtar për zbatimin e anketës. Shqyrtimi etik është i caktuar në kohë, në mënyrë që miratimet përfundimtare të merren nga bordi shqyrtues para fillimit të punës në terren.
5. **Materialet.** Bazuar në përmbajtjen e pyetësorëve dhe madhësisë së kampionit dhe sipas Udhëzimeve të Prokurimit të furnizimeve të MICS-it, llojet dhe sasi të furnizimeve të nevojshme për anketë përcaktohen dhe diskutohen me ZR të UNICEF-it. Furnizimet porositen nga Zyra e UNICEF. Duhet të lejohet kohë e mjaftueshme ndërmjet kohës së prokurimit dhe datës së pritshme të dorëzimit të artikujve, para fillimit të trajnimit para-testues dhe mbledhjes së të dhënave.
6. **Trajnimi për Listim dhe Listimi.** Trajnimi për listim bëhet për anketuesit dhe personat që merren me harta sipas rekomandimeve të përshkruara në Udhëzuesin e MICS-it për Hartëzimin dhe Listimin e njësive ekonomike familjare. Agjenda e trajnimit si dhe format e listimit që do të përdoren shqyrtohen nga eksperti rajonal i kampionimit dhe, kur përdoret, programi për mbledhjen e të dhënave shqyrtohet nga eksperti rajonal për përpunimin e të dhënave. Bazuar në përzgjedhjen e kampionit dhe sipas Udhëzuesit për Hartëzimin dhe Listimin e njësive ekonomike familjare, INSTAT-i kryen listimin dhe përzgjedhjen e njësive ekonomike familjare në njësitë primare të vrojtimit. Sipas nevojës, ZR e UNICEF-it dërgon ekspertin rajonal të kampionimit për të mbështetur trajnimin dhe/ose ditën e parë të listimit. Përzgjedhja e njësive ekonomike familjare dhe aplikacioni CAPI shqyrtohet gjithashtu nga eksperti rajonal i kampionimit, ose në distancë ose gjatë vizitës. Bëhet përzgjedhja e fazës së dytë të kampionit.
7. **Para-testimi i Pyetësorëve.** Pyetësorët para-testohen pas trajnimit të duhur. Agjenda e trajnimit, e cila duhet të jetë e ngjashme në përmbajtje me agjendën kryesore të trajnimit, paraprakisht shqyrtohet nga ZR e UNICEF-it. Eksperti rajonal i anketës mbështet trajnimin dhe para-testimin. Zhvillohet raporti i para-testimit dhe ndahet me ZR të UNICEF-it për shqyrtim. Pyetësorët finalizohen pas marrëveshjes së palëve. Duhet të lejohet kohë e mjaftueshme në mes të para-testimit të pyetësorit dhe para-testimit të aplikacionit CAPI për mbledhjen e të dhënave për të siguruar që të gjithë pyetësorët mund të shqyrtohen me kujdes para fillimit të para-testimit të aplikacionit CAPI për mbledhjen e të dhënave.

8. **Seminari mbi Përpunimin e të Dhënave.** Ekipi kombëtar i anketës duke përfshirë koordinatorin kombëtar të MICS-it për përpunimin e të dhënave dhe konsulentin kombëtar të MICS-it, marrin pjesë në këtë seminar për të forcuar aftësitë në shfrytëzimin e dy paketave programatike (softuerike) të përdorura në MICS (CSPRO dhe SPSS) dhe për të rritur të kuptuarit e metodologjisë së MICS-it në përpunimin e të dhënave, protokolleve, standardeve dhe udhëzimeve teknike. Eksperti rajonal për përpunimin e të dhënave merr pjesë në seminar dhe mbështet ekipin kombëtar, së bashku me ekipin Global të MICS për përpunimin e të dhënave, duke përshtatur aplikacionin për mbledhjen e të dhënave dhe programet e tabulimit (sintaksat). Në të njëjtin seminar, ekipi kombëtar i anketës familjarizohet me përshtatjen e arkivave të anketës. Koordinatori teknik i INSTAT-it dhe personi përgjegjës i MICS-it nga UNICEF-i gjithashtu marrin pjesë në këtë seminar.
9. **Aplikacioni për Mbledhjen e të Dhënave.** Gjatë seminarit të MICS-it për përpunimin e të dhënave, pjesëmarrësit trajnohen në përshtatjen e aplikacionit të MICS CAPI për mbledhjen dhe editimin e të dhënave dhe programet e tabulimit. Aplikacionet mund të përshtaten dhe kompletohen plotësisht në vend, bazuar në pyetësorët e para-testuar dhe përfundimtar dhe më pas dërgohen tek ZR/ZQ e UNICEF-it për shqyrtim. Pas kësaj aplikacioni CAPI për mbledhjen e të dhënave para-testohet dhe finalizohet. Para-testimi mbështetet nga eksperti rajonal i përpunimit të të dhënave.

III. Puna në terren

1. **Trajnimi për Punën në Terren dhe Studimi Pilot.** Kryhet trajnimi i personelit në terren, duke përfshirë praktikën në terren dhe një studim pilot. Eksperti rajonal i anketës së njësive ekonomike familjare i mobilizuar nga ZR e UNICEF-it mbështet trajnimin. Agjenda e trajnimit ndahet paraprakisht me ZR/ZQ të UNICEF-it për shqyrtim.
2. **Puna në Terren/Mbledhja e të Dhënave.** Eksperti rajonal i anketës, si dhe Koordinator i MICS-it nga ZR e UNICEF-it mbështet monitorimin e punës në terren (veçanërisht gjatë fazave të hershme). Përpilohen tabelat kontrolluese në terren. Ekipi vendor i anketës dhe ZR e UNICEF-it i shqyrtojnë dhe komentojnë tabelat kontrolluese në terren dhe të dhënat në kohë reale. Editimi dytësor ndodh njëkohësisht.

IV. Analiza

1. **Krijimi i Skedarëve të të Dhënave.** Përfundohet procesimi dhe editimi i të dhënave. Finalizohen peshat e kampionit, shqyrtohen nga eksperti rajonal i kampionimit dhe i bashkëngjiten dosjeve të të dhënave mikro. ZR e UNICEF-it mobilizon ekspertin rajonal të përpunimit të të dhënave për të ofruar asistencë teknike në vend për finalizimin e redaktimit të të dhënave dhe pastrimin e bazave të të dhënave, duke eksportuar skedarët në SPSS, si dhe duke finalizuar përshtatjen e programeve të tabulimit të SPSS-it. Skedarët CSPro, sintaksat e SPSS-it të përdorura për përgatitjen e të dhënave për analizë dhe skedarët e të dhënave mikro të anonimizuara ndahen me ZR/ZQ të UNICEF-it për shqyrtim. Skedarët përfundimtar të të dhënave mikro të anonimizuara prodhohen dhe janë të gatshëm për tabulim.

2. **Analiza e të Dhënave dhe Tabulimi.** Prodhet një set i tabelave të rezultateve të anketës. Programet e tabulimit SPSS dhe tabelat e përgatitura në përputhje me formatin dhe planin e përshtatur të tabulimit të MICS-it ndahen me ZR të UNICEF-it për shqyrtim. ZR e UNICEF-it mobilizon ekspertin rajonal të anketës së njësive ekonomike familjare për të ofruar asistencë teknike sipas nevojës. Ekipi kombëtar i anketës i përshtat tabulimet dhe programet bazuar në sugjerimet e marra dhe i ndanë me ZQ të UNICEF-it për shqyrtim të konsoliduar. Tabulimet përfundimtare, duke përfshirë cilësinë e të dhënave dhe tabelat e gabimeve të kampionimit, do të prodhohen për Raportin e gjetjeve të anketës (RGjA).
3. **Seminari mbi Interpretimin e të Dhënave, dhe Përpilimit të Raportit.** Ekipi kombëtar i anketës merr pjesë në këtë seminar, i cili organizohet në vend, për të rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre në interpretimin e të dhënave dhe për të shqyrtuar dhe diskutuar gjetjet e anketës me ekspertë globalë dhe rajonalë. Në të njëjtin seminar, ekipet e vendit identifikojnë fushat potenciale për analiza të mëtejshme, zgjerojnë njohuritë e tyre për mjete dhe metoda të ndryshme për shpërndarjen efektive të të dhënave të MICS dhe bëjnë progres në punën e arkivimit. Modele dhe shembujt e shpërndarjes së MICS ofrohen nga ZR/ZQ e UNICEF-it.

V. Shpërndarja e Rezultateve të Anketës

1. **Raporti i Gjetjeve të Anketës.** Draftet e gjetjeve statistikore punohen nga INSTAT dhe ndahen me ZR/ZQ të UNICEF-it për shqyrtim. Gjetjet statistikore rishikohen dhe dakordësohen midis palëve.
2. **Publikimi:** Në momentin e lançimit ose menjëherë pas publikimit të rezultateve të anketës në nivel vendi, Ekipi MICS i UNICEF-it ngarkon RGjA në faqen mics.unicef.org për shpërndarje globale.
3. **Përfundimi i Arkivimit.** Përfundohet arkivimi i anketës së MICS. Ekspertët rajonalë të UNICEF-it për anketën e njësive ekonomike familjare dhe ekspertët e përpunimit të të dhënave e shqyrtojnë dhe japin komente. Arkivi përfundimtar ndahet me ZQ të UNICEF-it për shqyrtim dhe më pas finalizohet dhe ngarkohet në mics.unicef.org.
4. **Ndarja e të Dhënave.** Me mbështetjen e ZR/ZQ të UNICEF-it skedarët e të dhënave mikro anonimizohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare¹, vecanërisht Artikulli 24 i Ligjit 124/2024 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale", në mënyrë që asnjë individ, njësi ekonomike familjare ose vendndodhje e grupit të mos identifikohet. Një grup variablash standarde i shtohen skedarëve të mikro të dhënave së bashku me çfarëdo shënimi të nevojshëm për përdorimin e të dhënave dhe informacionin e kontaktit të INSTAT-it. Trajnimi online mbi anonimizimin e skedarëve të të dhënave nga anketa ofrohet nga Ekipi MICS i UNICEF-it, sipas nevojës. Skedarët e të dhënave mikro të

¹ Ligji 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" - https://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf

Ligji 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale" - <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/12/19/124/921d3810-ab2a-4e45-bdca-bef3a84b2721>

anonimizuara, sintaksa e tabulimeve dhe metadatat (përjashtuar gjeokodet) ngarkohen në faqen mics.unicef.org. Shkëmbimi i të dhënave të anonimizuara do të dakordësohet me ekipin MICS të UNICEF dhe do të shqyrtohet veçmas, jashtë objektit të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

5. **Shpërndarja dhe Analiza e Mëtejshme.** Prodhohen materialet për shpërndarje dhe planifikohet analiza e mëtejshme e të dhënave të MICS-it në bashkëpunim me partnerët. Mbështetja për prodhimin e materialeve për shpërndarje dhe analiza të mëtejshme do të sigurohet, sipas kërkesës, nga ZR dhe ZQ e UNICEF-it, nëse është e nevojshme. Ekipi i MICS-it i UNICEF-it mund të organizojë Seminare Globale për Analiza të Mëtejshme Tematike që mund të jenë relevante për anëtarët e ekipit të anketës.

VI. Afatet Kohore të Zbatimit të Anketës

1. Ky planifikim kohor synon të udhëheqë përpjekjet e koordinuara të INSTAT dhe UNICEF për të arritur rezultate të anketës në kohë dhe me cilësi të lartë. INSTAT dhe UNICEF do të zhvillojnë takime të rregullta për të koordinuar dhe monitoruar ecurinë e anketës duke adresuar çdo vonesë apo sfidë.
2. Afatet kohore të mëposhtme mund të jenë subjekt i rregullimeve të bazuara në nevojat operative dhe faktorët kontekstualë.

Faza	Aktivitetet	Afati Kohor
Planifikimi dhe logjistika	Përditësimi i MoU, Planit të Anketës, Buxhetit dhe Protokollit të Mbrojtjes.	Gusht 2025
	Prokurimi i materialeve.	
Përshtatja e pyetësorëve	Trajnimi dhe testimi paraprak i pyetësorëve.	
	Përgatitja e raportit nga testimi paraprak i pyetësorëve; finalizimi i pyetësorëve.	
Kampionimi dhe Listimi	Përgatitja e materialeve të listimit dhe përshtatja e aplikacionit të listimit CAPI për trajnimin e listimit dhe listimin.	Gusht 2025
	Trajnimi i personelit për listimin.	Shtator – Tetor 2025
	Kryerja e listimit dhe përgatitja e raportit të listimit.	Shtator – Tetor 2025
	Përzgjedhja e kampionit.	Tetor – Nëntor 2025
	Përditësimi i gjeo-databazës pas listimit	Tetor – Nëntor 2025
	Përgatitja e hartave për punën në terren	Tetor – Nëntor 2025

	Përgatitja e kampionit për aplikacionin CAPI.	Nëntor 2025
Programet e përpunimit të të dhënave	Përshtatja e aplikacionit CAPI.	Gusht – Nëntor 2025
	Trajnimi, testimi i aplikacionit CAPI në terren dhe përgatitja e raportit.	Tetor – Nëntor 2025
Trajnimi i stafit të terenit dhe puna në teren	Trajnimi i stafit të punës në terren.	Dhjetor 2025
	Mbledhja e të dhënave në terren.	Dhjetor 2025 – Shkurt 2026
Përpunimi i të dhënave	Editimi sekondar dhe pastrimi i të dhënave.	Janar – Prill 2026
	Përgatitja e peshave të anketës.	Mars- Prill 2026
	Finalizimi i dataseteve për analizat paraprake.	Prill 2026
	Anonimizimi i gjeokodeve të grumbullimit dhe llogaritja e kovarianteve gjeohapësinore.	Qershor – Shtator 2026
Analiza dhe tabulimi i të dhënave	Përshtatja e Planit të Tabulimit.	Tetor-Dhjetor 2026
	Përshtatja e sintaksave SPSS.	Tetor-Dhjetor 2026
	Popullimi i Planit të Tabulimit.	Tetor-Dhjetor 2026
Shkrimi dhe shpërndarja e raportit të gjetjeve	Raporti preliminar i gjetjeve	Prill 2026
	Përgatitja e Raportit të Gjetjeve të Anketës.	Maj-Shtator 2026
	Shpërndarja e Raportit të Gjetjeve të Anketës.	Shtator 2026
Arkivimi	Mbledhja e dokumenteve/ materialeve për arkivin e anketës.	Përgjatë gjithë projektit
	Përgatitja e arkivit të anketës.	Përgjatë gjithë projektit